

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIIN)

Dija / el-ilm /

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

" "

“... dhe (Ne) i mësuam atij një dije (të caktuar).” (el-Kehf, 60)

Dije është ajo, që mund të verifikohet me anë të provave dhe që largon padijen. Kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është dija e dukshme (e jashtme), e cila verifikohet:

- Me anë të të parit të syve ose
- Me anë të rënies në ujdi ose
- Me anë të eksperimentimit të vlefshëm¹

Niveli i dytë është dija e fshehtë (e brendshme), e cila:

- Buron nga sekretet² e dëlira të trupave³ të dëlirë nëpërmjet ujit të dëlirë të ushtrimit/disiplinës (shpirtërore).

¹ Rënia në ujdi ose dija e përhapur duhet të jetë e bazuar në një premisë të pakundërshtueshme, siç është dija e përhapur se Kina ekziston, gjë që bazohet në pajtimin e shumë njerëzve që e kanë parë. Përveç të parit të syve, edhe pjesa tjetër e shqisave verifikon dijen. Përveç eksperimentimit, intelekti mund të arrijë dije nëpërmjet induksionit dhe deduksionit. Përveç kësaj, është dija e Shpalljes, e përcjellë nga ai (pejgamberi ﷺ), vërtetësia e të cilit është verifikuar. Pastaj kemi dhe dijen e lindur, e cila është e pjesë integrale e shpirtrave tanë, siç është dija për ekzistencën e një Krijuesi, dija se tërësia është më e madhe sesa pjesa, dhe ligji i mospasjes së kontradiktave (thëniet kontradiktore s’mund të jenë të dyja të vërteta njëkohësisht, d.m.th. A të jetë edhe A, edhe B).

² Elementi më i thellë i shpirtrave.

³ Trupat që janë rritur në hallall dhe i janë nënshtruar udhëzimit hyjnor.

- Dhe shfaqet në shpirtrat e sinqertë, me aspiratat më të larta, gjatë kohëve të pazëna të dëgjimit të vëmendshëm (perceptimit të sinjaleve nga Zoti)
- Është një dije që e bën të dukshme të padukshmen dhe bën që të zhduket e dukshmja, dhe e kthen vëmendjen drejt bashkimit⁴.

Niveli i tretë është dija “*ledunn*” (drejtpërsëdrejti nga Zoti)⁵:

- Referimi i saj është vetë ekzistenca e saj⁶
- Realizimi i saj arrihet nëpërmjet vështrimit⁷ dhe
- Aftësia për ta identifikuar atë është e lindur⁸

Mes kësaj dije dhe të padukshmes s’ka perde.

⁴ Bashkimi/shoqërimi me Allahun në kuptimin sunit. Shih kaptinën rreth Kushtimit të plotë (*Tebettul*).

⁵ Dije me origjinë hyjnore. Në ajetin me të cilin shejhu nis kaptinën, kjo i referohet dijes që i qe dhënë Hidrit drejtpërsëdrejti, jo nëpërmjet Musës ﷺ. Musa qe dërguar te Beni Israilët e jo tek i gjithë njerëzimi, ndërsa Hidri mund të ketë qenë një peygamber. Ibn el-Kajjim thekson në Medaarixh se është herezi e hapët dhe një dalje e qartë nga feja të pohosh se sheriat i Muhamedit ﷺ nuk është i detyrueshëm për dikë ashtu siç sheriat i Musës ﷺ nuk qe i detyrueshëm për Hidrin. Rreth kësaj s’duhet të ketë kurrfarë mospajtimi. Dija që marrin zemrat tona, vetëm plotësojnë dijen tonë të shariatit duke na udhëzuar drejt të kuptuarit të saktë dhe zbatimit të saj, dhe na ndihmojnë t’i bëjmë zgjedhjet e duhura. Sipas Ibn Tejmijes, ky është konteksti ku mund të ndihmojnë frymëzimi (*ilhaam*) dhe intuita (*dhewk*).

⁶ Kjo nuk nënkupton nënvleftësimin e dijes së Shpalljes, të përcjellë nëpërmjet zinxhirëve të transmetuesve. Asnjë dijetar sunit, siç qe edhe shejh Harawi, nuk do të orvatej ta bënte këtë, ndonëse e kanë bërë shumë pretendues të devijuar të sufizmit. Kapja për Kuran dhe Sunet ashtu siç qe kuptuar nga paraardhësit e drejtë dhe siç na është përcjellë nga Imamët e mëdhenj të Ehlu-Sunetit, është dallimi mes sufizmit sunnit dhe sufizimit heretik.

⁷ Ndryshe nga llojet e tjera të dijes, që mund të arrihen me anë të shqisave dhe reflektimit, kjo mund të realizohet me anë të shikimit të zemrës që Zoti i jep robrit.

⁸ Do të thotë se ti i njeh cilësitë e kësaj dije vetëm pasi ta arrish. Këtë dije s’mund ta arrish duke ndjekur një hartë (metodë të caktuar).